

Konferenca TeachBeyond Shqipëri

Me gëzim presim të jemi së bashku në Konferencën e 6-të vjetore të mësuesëve me temë:

Edukimi që ndërton mençurinë

Biografia e Prezantueses - Debbie Hume



RN, M.Ed., CET, BCB, BCN, QEEG-D

Debbie Hume është e specializuar në çrregullimet e trurit, dhe një Terapiste Edukative e Certifikuar nga National Institute for Learning Development. Ajo ka gjithashtu certifikime profesionale në Biofeedback, Neurofeedback dhe shërbime të Hartëzimit të trurit.

Ajo ka shërbyer për shumë vite në organizata që promovojnë shëndetin mendor dhe mirëqënien e fëmijëve në Azinë Juglindore. Debbie ka mbajtur trajnime profesionale në Kinë, Tajlandë dhe Indonezi dhe vazhdon të ndajë ekspertizën e saj ndërkombëtarisht. Ajo punon privatisht në Weatherford, Texas, ku ndihmon fëmijë dhe të rriturit me vështirësi dhe çrregullime të shëndetit mendor.

Workshop 1

Skenari në Klasë: Cili është Problemi?

Fokusi i workshop-it

Të kuptuarit e çështjeve mjekësore dhe të shëndetit mendor që ndikojnë në të nxënit tek fëmijët e vegjël.

Përshkrimi i workshop-it

Suksesi në të nxënit nuk është gjithmonë i lehtë. Edhe me mësimin më të mirë, disa nxënës përballen me vështirësi të fshehura që e bëjnë procesin e të nxënit më të vështirë.

Në këtë workshop, pjesëmarrësit do të eksplorojnë një sërë skenarësh të zakonshëm në klasë dhe do t'i përgjigjen pyetjes: **“Cili është problemi?”** Ata do të përpiqen të gjejnë përgjigjen dhe më pas do të zhvillohet diskutim me shpjegimin përkatës. Këto “probleme” lidhen me çështje mjekësore ose të shëndetit mendor që hasen shpesh tek fëmijët në ciklin fillor.

Përmes këtij formati interaktiv, mësuesit do të marrin një kuptim praktik se si të identifikojnë dhe të mbështesin nxënësit që përballen me sfida të mbështetura në faktorë shëndetësorë ose zhvëllimorë, e jo thjesht motivim apo sjellje.

Workshop 2

Dy A-të: Autizmi dhe ADHD

Fokusi i workshop-it

Si funksionon truri ndryshe tek individët me diagnozë Autizëm dhe ADHD.

Përshkrimi i workshop-it

Nxënësit me Autizëm ose ADHD shpesh e lënë mësuesin e klasës të ndjehet i tejngarkuar, teksa përpiqet të përmbushë nevojat e tyre krahas detyrimeve të shumta të ditës. Ky prezantim hedh një vështrim të thellë në mënyrën se si funksionon truri ndryshe tek individët me këto diagnoza dhe pse këto dallime mund të shkaktojnë sfida në klasë. **Pjesëmarrësit do të mësojnë:**

- Bazat neurologjike të Autizmit dhe ADHD
- Si ndikojnë këto dallime në të nxënit, vëmendjen, sjelljen dhe rregullimin emocional
- Strategji praktike dhe këshilla për klasën për të mbështetur këta nxënës
- Opsione trajtimi dhe ndërhyrje të mundshme që mund t'i ndihmojnë fëmijët me këto diagnoza

Ky workshop pajis mësuesit me mirëkuptim dhe mjete konkrete që u japin besim dhe shpresë në mjedisin e klasës.

Ju falënderojmë për interesimin dhe ju mirëpresim në këtë event të rëndësishëm për zhvillimin profesional të mësuesve.